



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR AKTIVET E LEJUARA, KUFIZIMET DHE KUFIRIN MAKSIMAL TË
INVESTIMIT TË FONDIT TË PENSIONIT**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 1, datë 28.01.2010

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 18.10.2010

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 32, datë 21.03.2012

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 120, datë 24.08.2016

Neni 1

Baza ligjore dhe qëllimi

1. Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 63, të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe pikës 2 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".*
2. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë aktivet e lejuara, në të cilat mund të investohet fondi i pensionit, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit.

Neni 2

Investimet e lejuara

Asetet e një fondi pensioni mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- a) Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- b) Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
- c) Bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- d) Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë;*
- e) Letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody's ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);

- f) Aksione ose kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE- së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

Neni 3

Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar

Asetet e një fondi pensioni nuk mund të investohen më shumë se:

- a) 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- b) 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- c) 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody's, ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 %, në një emetues të vetëm;
- d) 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:
- i. Që asetet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose;
 - ii. Që asetet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.
- e) 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- f) 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
- i. Jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm;
 - ii. Kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.